

# *Ndikimi i shprehjeve të huaja në Kodin penal dhe në Kodin e procedurës penale të Republikës së Kosovës*

*Vjosa Jonuzi – Shala\**

## **Pëmbledhje**

Globalizmi është definuar si proces ekonomik, politik, shoqëror dhe kulturor, efekti i të cilit është ndikimi në nivel gjithë-botërorë përkatësisht, gjithëpërfshirës. Nga ky përkufizim, rrjedh se ky proces është shumëdimensional; ka përfshirë globin, nga këndvështrimi fizik dhe krahas kësaj, ka ndikuar në mënyrë gjithëpërfshirëse në pothuajse, në mos jo të gjitha, sferat e jetës së njeriut dhe të shoqërive në tërësi. Si i tillë, konsiderohet edhe i pashmangshëm.

Me gjithë anët pozitive të cilat i sjellë procesi i globalizimit, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin teknologjik i cili mundëson “zvogëlimin” e rruzullit në kohë dhe në hapësirë, në mënyrë të pashmangshme ky proces sjell edhe pasoja të caktuara, të cilat gjithsesi, janë negative. Si rezultat i kësaj, kanë lindur edhe tendencat dhe pozicionime diametralisht të kundërta; në njërin anë përkrahësit absolutë të këtij procesi dhe në anën tjetër, kundërshtarët absolutë të këtij procesi.

Është më se e vërtetë se globalizmi ndryshon marrëdhëniet, jo vetëm ato politike dhe ekonomike, por edhe ato shoqërore dhe kulturore. Në këtë kuptim, globalizmi manifestohet edhe në sferën shkencore dhe gjuhësore. Kjo është më se e dukshme edhe në hapësirën shqiptare, në të cilën ky ndikim është jashtëzakonisht i shprehur.

Në shkencën e të drejtës penale dhe procedurale – penale në Kosovë, ky ndikim është i dyfishtë: derisa në Kodin penal të Republikës së Kosovës, ndikimi i përket gjuhës dhe në masë të caktuar është manifestuar me shprehje nga gjuha angleze, në Kodin e procedurës penale, ky ndikim manifestohet edhe në vetë substancën e procedurës penale.

Koha është duke e dëshmuar se përdorimi i shprehjeve të huaja në gjuhën shqipe shumë herë është nevojë, sepse duke i parë ndikimet në këto dy kode, shohim se, megjithatë, gjuha shqipe nganjëherë nuk mjafton. Si rrjedhojë, huazimet gjuhësore paraqesin “shpëtimin” e vetëm. Dhe kjo duhet të zgjasë vetëm për një kohë, dhe atë, derisa të

---

\* Dr. Vjosa Jonuzi-Shala, Kolegji AAB, email: [vjosa.jonuzi@aab-edu.net](mailto:vjosa.jonuzi@aab-edu.net)

“gjendet” shprehja në gjuhën shqipe. U mbetet gjuhëtarëve, në radhë të parë dhe studiuesve të sferës penale në përgjithësi që t’i “krijojnë”, që t’i “zbulojnë” dhe më pas t’i nxjerrin në përdorim shprehjet, të cilat medoemos duhet të jenë shqipe dhe të cilat në mënyrë të saktë përkrijnë me kuptimin, pa lënë mëdyshje, kur kemi parasysh këtë sferë shumë delikate të së drejtës.

**Fjalë kyç:** globalizmi, barbarizmat, huazimet, drafti, implementimi, ndikimet gjuhësore, dhunimi, kontrabandim, trafikim, shkronja e madhe, albanologjia, lektorët, institucionet shtetërore, gjuha shkencore, ligji mbi mbrojtjen e gjuhës shqipe.

## Hyrje

Përkufizimet e globalizmit janë të shumëllojshme. Kështu sipas *Oxford Dictionary*, “globalizmi është proces, sipas të cilit bizneset ose organizatat e tjera zhvillojnë ndikim ndërkombëtar ose fillojnë të veprojnë në shkallë ndërkombëtare”.<sup>1</sup> Një përkufizim më i përgjithshëm e definon si “proces i cili përfshinë shkaqet, rrjedhën dhe pasojat e integritit ndërkombëtar dhe ndër-kulturor të veprimtarive njerëzore dhe jo-njerëzore”,<sup>2</sup> ndërkaq, e përkufizuar në mënyrë më të thjeshtë, “globalizmi është proces i interaksionit ndër-kulturor, shkëmbyes dhe transformues”.<sup>3</sup> Në këtë kuptim, globalizmi është proces nga i cili burojnë shkëmbimet e pikëpamjeve mbi botën, prodhimet, idetë dhe aspektet e tjera të kulturës; globalizmi i referohet proceseve që nxisin mbarë botën në shkëmbime kombëtare dhe kulturore. Marrë në tërësi, një pjesë e autorëve, globalizmin e identifikojnë vetëm me tregun, gjithë-përfshirjen tregtare dhe

---

<sup>1</sup> Oxford Dictionaries, s.v. “Globalization”,

<http://oxforddictionaries.com/definition/english/globalization> (parë për herë të fundit më 02/02/2015).

<sup>2</sup> Dr. Nayef R.F. Al-Rodhan, *Definitions of Globalization: A Comprehensive Overview and a Proposed Definition* (Geneva: Centre for Security Policy, 2006), 5.

<sup>3</sup> Vilashini Cooppan, “World Literature and Global Theory: Comparative Literature for the New Millennium”, *Symploke*, Vol. 9, No. 1/2, (2001): 15.

rrjedhimisht atë financiare,<sup>4</sup> ndërsa pjesa tjetër e autorëve, globalizmin, përveç “tregtisë pa kufij”, e identifikojnë edhe me kategori të tjera jo-financiare, si: kultura, shkenca, gjuha, religjioni, migrimi, politika, vlerat, normat, ideologjia; madje “globalizmi është çasti i migrameve masive, multikulturalizmit dhe kosmopolitanizmit”.<sup>5</sup>

### ***Tendencat gjuhësore në Kodin penal dhe në Kodin e procedurës penale të Republikës së Kosovës***

Një hov i tillë globalizues ka përfshirë edhe Kosovën dhe rrjedhimisht edhe gjuhën shqipe. Duke e përjashtuar shkencën e teknologjisë informative, për të cilën madje edhe rëndom përdoret shprehja IT (*Information Technology*), tendencat e përdorimit të shprehjeve të huaja, në masë shumë të madhe të atyre të gjuhës angleze, janë të pranishme pothuajse në të gjitha komunikimet tona. Shprehjet: president, implementim, transparencë, resurse, draft, prokurim, revizion, eksperiencë, kooperim, fokus, investigim, tender, imediat, aset, abuzim, akordim, target, e shumë të tjera, janë rrënjosur aq thellë në gjuhën tonë, sa që jo vetëm që kemi “harruar” se nuk janë shprehje shqipe, por edhe fjalori elektronik i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, i kupton dhe pranon si fjalë shqipe, ndaj edhe me rastin e përdorimit të tyre në kompjuter, nuk rezultojnë si të huaja, por si shprehje të gjuhës shqipe.

Kjo tendencë është manifestuar edhe në Kodin penal dhe në Kodin e procedurës penale të Republikës së Kosovës. Në kushte të tilla, shumë herë bëhet e vështirë që këto kode të kryejnë funksionin për të cilin edhe janë nxjerrë. Rrjedhimisht, në rrethana të tilla, mund të

---

<sup>4</sup> Al-Rodhan, vep. e cit., f. 16. (I referohet Alan Deardorff, “Glossary of International Economics”, University of Michigan, 2001).

<sup>5</sup> Al-Rodhan, vep. e cit., f. 10 dhe 17. [I referohet Mike Featherstone, *Undoing Culture, Globalization, Postmodernism and Identity*, (London: Sage, 1995), 6-7, H.J.J.G. Beerkens, “Global Opportunities and Institutional Embeddedness, Higher Education Consortia in Europe and Southeast Asia”, *University of Twente*, 2004 dhe Imre Szeman, “Culture and Globalization, or, The Humanities in Ruins”, *CR: The New Centennial Review*, Vol. 3, No. 2, (2003): 94].

krijohen situata të paqarta, të cilat mund të kenë si pasojë dështimet në luftë kundër kriminalitetit.

Tendencat e tilla janë më të hershme, ndonëse me intensitet shumë më të shtuar ndodhin nga fundshekulli i kaluar, kur vendi është gjetur nën administrim ndërkombëtar. Në fillim, ndikimet gjuhësore nga sllavishtja që më vonë të vazhdojnë nga gjuha angleze. Pa hyrë në analiza shumë të thella, të cilat kanë të bëjnë me ndikimin në gjuhën shqipe, duhet përkujtuar shprehjen “dhunim”, e cila i referohet atij seksual, shprehje e cila vjen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sllavishtja, “*silovanje*”. Kjo shprehje është përdorur në Kodin penal të vitit 2003, por edhe të atij të vitit 2013 dhe i referohet kësaj veprë penale. Kjo shprehje është përvetësuar nga sllavishtja, duke e përkthyer në mënyrë bukëvale, pa i përfillur elementet tona gjuhësore (*sila* – dhunë dhe *silovanje* – dhunim), ndërkohë që, për dallim prej sllavishtes, ku shprehja “*silovanje*” ka kuptim ekskluzivisht të dhunimit seksual dhe përdoret vetëm në kontekst të këtij veprimi, në gjuhën shqipe shprehja “dhunim”, nuk ka ekskluzivitetin e tillë, sepse e njëjta përdoret për pothuajse secilën dhunë, e cila ushtrohet ndaj personit ose objektit. Sipas gjuhës shqipe, personi mund të dhunohet, por kjo dhunë mund të mos jetë seksuale (dhunohet psikologjikisht, dhunohet fizikisht). Gjithashtu, sipas gjuhës shqipe, përveç njeriut, mund të dhunohet edhe objekti, varri, etj., që nënkupton se shprehja “dhunim” ka përfshirje shumë më të madhe dhe nuk i referohet vetëm atij seksual, por edhe formave të tjera të të ushtruarit të dhunës. Kjo është e njëjtë edhe për gjuhën angleze, sipas të cilës shprehja “rape” ka vetëm një kuptim: dhunim seksual dhe nuk përdoret në asnjë kontekst tjetër. Ndërkaq, për kryesin e dhunimit seksual, përdoret shprehja dhunues, që në të vërtetë e njëjta përdoret edhe për kryesit e llojeve të tjera të dhunës, jashtë kontekstit seksual.

Në Kodin penal të Kosovës, është paraparë vepra penale – Kontrabandimi me migrantë (neni 170). Shprehja kontrabandim (fr. *contrabande*, it. *contrabando*), ka kuptimin e “futjes ose nxjerrjes fshehurazi të mallrave të ndaluara ose të sendeve me vlerë nëpër kufirin shtetëror, duke përdorur mënyra të jashtëligjshme për t’i

shpëtuar kontrollit doganor; tregti e fshehtë me mallra të tilla”,<sup>6</sup> ndërsa, në Kodin penal të Kosovës, kjo vepër penale i referohet ekskluzivisht njerëzve, sepse për mallrat ka norma të tjera. Gjithashtu, edhe shprehja “migrantë” nuk ekziston në gjuhën shqipe; përdoren shprehjet “emigrantë” ose “imigrantë”, ndërsa migrimi është dukuri e zhvendosjes së popullatës nga një vend në vendin tjetër.<sup>7</sup> Më tej, është paraparë vepra penale – sulmi (neni 187/1), në rastet kur “kushdo që me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër, pa pëlqimin e atij personi...” dhe vepra penale e dhunimit (neni 230/1), “kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit...”, ndërsa sipas shkencës penale – juridike të Kosovës deri më sot, nuk ka mundur të ndodhë e kundërta; përdorimi i forcës (armës, mjetit të rrezikshëm apo ndonjë sendi tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të shëndetit) me pëlqim të subjektit pasiv përkatësisht detyrimi për të kryer akt seksual, por me pëlqim të subjektit pasiv. Gjithashtu, në nenin 35 është paraparë “veprimi i rëndësishëm drejt kryerjes së veprës penale”, i cili është përkufizuar si “hap i rëndësishëm përgatitor...”, por i cili nuk është veprim përgatitor, por një hap më shumë, e megjithatë nuk është tentativë; qëndron mes veprimit përgatitor dhe tentativës! Në të tilla raste shfaqen institute të reja penale – juridike, të cilat vijnë si rezultat i ndikimit të sistemit të huaj dhe si rrjedhojë edhe fondi i shprehjeve në gjuhën tonë, nuk mund t’i përballojë.

Ndikimet në kodet tona, atë penal dhe procedural – penal nuk janë vetëm ndikime gjuhësore nga gjuha angleze. Këto janë ndikime edhe në përmbajtje, ndikime faktike, të cilat rrjedhimisht, manifestohen edhe në terminologjinë shqipe. Kjo dukuri është shumë më e shprehur në Kodin e procedurës penale, në të cilin ndikimet në themel të këtij kodi, në shumë raste zbatuesit të tij, mund t’i krijojë mëdyshje dhe medoemos nevojën për interpretim. Kjo për faktin se jo vetëm tradita legjislative penale në përgjithësi, por edhe shprehjet e gjuhës angleze, të cilat i përkasin kësaj sfare, janë shumë herë më të pasura se sa ato

---

<sup>6</sup> Fjalor i shqipes së sotme, bot. 2, s.v. “Kontrabandë.” Po ashtu, Milan Vujaklija, *Leksikon stranih reči i izraza*, bot. 3, s.v. “Kontrabanda.”

<sup>7</sup> Fjalor..., s.v. “Migrimi.”

në gjuhën shqipe. Kështu, fjala vjen llojet e dyshimit (*suspicion*), që në gjuhën angleze kanë tri nivele (*reasonable, grounded dhe well-grounded*),<sup>8</sup> kanë hyrë edhe në Kodin e procedurës penale të Republikës së Kosovës të përkthyer si: dyshim i arsyeshëm, dyshim i bazuar dhe dyshim i bazuar mirë, që dëshmon jo vetëm për një terminologji të re të gjuhës procedurale – penale, por edhe për kategori tërësisht të reja, të cilat duhet përpunuar në mënyrë shkencore.

Një tjetër shprehje në këtë kod është “shkaku i bazuar” (neni 19, pika 1.10), i cili “duhet të mbështet në prova të artikulueshme”, dhe që edhe “shkaku i bazuar” edhe “prova e artikulueshme”, janë kategori të reja, të cilat kërkojnë të trajtohen në mënyrë shkencore. Ndonëse shprehja e “artikulueshme”, e cila i referohet provave dhe shkaqeve të bazuara (“provë e artikulueshme” dhe “bazë e artikulueshme”), është paraparë në një numër tejet të madh të dispozitave të Kodit të procedurës penale, kuptimi i kësaj shprehjeje nuk është përkufizuar në kod, përveç se një dispozite (neni 19, pika 1.30), e cila mbetet në tentativë të përkufizimit! Gjithashtu, ndikim nga gjuha angleze ka edhe shprehja “rrezik serioz”, e cila përkufizohet si “frikë e justifikueshme...” (neni 220, pika 1.1), që në mënyrë të qartë lë për të kuptuar se ka edhe rrezik joserioz përkatësisht, që niveli i seriozitetit të rrezikut mund të jetë i rëndomtë (rrezik) dhe më i lartë (rrezik serioz), por që, megjithatë, të dyja janë rreziqe. Kjo sepse në KPPK është paraparë “rreziku” dhe “rreziku serioz”, në varësi të situatës dhe kontekstit. Në situata të tilla, i mbetet teorisë dhe praktikës gjyqësore që të ballafaqohen me kategori të tilla, të cilat edhe për një kohë të gjatë do të mbesin relative. Ose, shprehjet “Zyrtar i autorizuar i policisë” (*Authorized Police Officer*), “Policia apo zyrtari policor” (*Police or Police Officer*),<sup>9</sup> “Çështje e ndërlikuar” (*Complex Crime*), “Thelbësisht të pambështetshme” (*Intrinsically Unreliable*), “Mbështetje e pohimit” (*Notice of Corroboration*), “Përshtatshmëria e mbrojtjes” (*Adequacy of Defence*), “Kompetenca e

---

<sup>8</sup> Në Kodin penal të Kosovës të vitit 2003, ishin paraparë këto lloje të dyshimit: i arsyeshëm, serioz, i konsiderueshëm dhe i bazuar!!!

<sup>9</sup> Nga përkufizimi i këtyre shprehjeve (neni 19/1.1 dhe 1.32), dallimet mes tyre nuk mund të kuptohen!!!

nënkuptuar e gjykatave" (*Implicit Jurisdiction of Courts*), "Diversioni" (*Diversion*), "Ngrirja e përkohshme e asetëve" (*Temporary Freezing of Assets*),<sup>10</sup> etj., të cilat pa efekt konkret dhe të mirëfilltë janë paraparë në kod me këtë terminologji, duke lënë anash faktin se shumë nga to, vërtetë duhet përkufizuar, duke e dhënë shpjegimin e tyre thelbësor, shpjegim ky i cili në Kodin e procedurës penale aktualisht mungon.

Për sa i përket gjuhës penale dhe procedurale – penale, por dhe gjuhës në mediumet tona në përgjithësi, duhet përkujtuar se shprehjet e huaja nuk duhet përdorur, derisa i kemi në gjuhën tonë. "Shërbimet inteligjente" janë shërbimet sekrete, "impakti" është ndikimi, "detyra imediate" është detyra e menjëhershme, "konfidenciale" është e/i fshehtë, "violente" është e dhunshme, "akcesi" është qasje, "intervistimi i policisë" është marrja në pyetje nga policia, "menaxhimi i resurseve humane" është menaxhimi i burimeve njerëzore, "investigimi" është hetimi, "ngrirja e përkohshme e asetëve" është marrja e përkohshme e pasurisë, "amandamentim" është ndryshim dhe plotësim i ligjit, "tender" është ofertë, "aparencë" është shfaqje, pamje e jashtme, paraqitje, "president" është kryetar, "policimi" është përcaktimi i politikave, zbatim i politikave, "draftimi i ligjit" është plani, përgatitja e ligjit, "u akorduan" është u morrën vesh, "abuzim" është keqtrajtje, "kooperim" është bashkëpunim, "transparenca" është dukshmëri, "performanca" është shfaqje, ekzekutim dhe shumë të tjera.

Me gjithë depërtimet e shprehjeve të huaja, është duke ndodhur edhe dukuria, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë po manifestohet edhe në gjuhën e shkruar, kur pa asnjë kriter dhe kundër rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, vend e pa vend përdoret shkronja e madhe, pavarësisht se shkronja e madhe në gjuhën shqipe në mes të fjalisë përdoret në situata shumë mirë të përcaktuara. Madje, me shkronjë të madhe shkruhet secila fjalë e një fjalie! Një dukuri e tillë është shkelle e rëndë e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. "Futja" e shkronjës së madhe është dëshmi e qartë e ndikimit të gjuhës së shkruar angleze, ku kjo është rregull gjuhësore. Dhe kjo ndodh edhe në Kodin e procedurës penale të Republikës së Kosovës ("Kodi i

---

<sup>10</sup> Nenet: 19, pika 1.2, 1.29, 1.31, neni 11, neni 38, neni 184, neni 264, etj.

Drejtësisë për të Mitur”, “Departamenti i Krimeve të Rënda”, “Ligji për Gjykatat”, “Departamenti për të Mitur”, neni 21, “Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit”, neni 98, “Zbatimi i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ndaj të paraburgosurve”, neni 202, etj.), por edhe në Kodin penal të Republikës së Kosovës (“kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme”, neni 120/4.2, “Ligji për Shoqëritë Tregtare”, neni 120/7, “Komisioni Zgjedhor”, neni 215/4 dhe shumë të tjera sipas nenit 441 dhe 442). Dhe, një dukuri e tillë është duke ndodhur me vrull jo vetëm në këto dy kodet e Kosovës, por pothuajse edhe të gjitha shkrimet, pavarësisht nivelit dhe sferës të cilën e përfshijnë. Një përfundim i tillë është nxjerrë edhe më herët nga gjuhëtarët tanë, sipas të cilëve “... me mbisundim të elementit anglo-amerikan, gjuha shqipe e përdorur mish-mash, me frymë, model dhe me fjalor të huaj, rrezikohet të bëhet si kanadishtja; gjuhë me gramatikë angleze e me fjalor amerikan, apo si anglishtja e përkthyer në gjuhën shqipe”.<sup>11</sup>

Duhet pasur parasysh një të dhënë sipas të cilës, gjuha angleze ka mbi një milion shprehje dhe për çdo vit “zgjerohet” me rreth 8.500 të tilla,<sup>12</sup> ndërsa sipas një të dhëne tjetër, kjo gjuhë pasurohet me mbi 25.000 fjalë të reja për çdo vit.<sup>13</sup> Mjafton të përmendet fakti se Fjalori i Oxfordit, përmban mbi 600.000 fjalë me rreth 3 milionë citate.<sup>14</sup> Se sa e

---

<sup>11</sup> Pjesë nga kumtesa e paraqitur në Simpoziumin Shkencor “50 vjet studime Albanologjike”, e mbajtur në Prishtinë më 18/19 dhjetor 2003, organizuar nga Instituti Albanologjik me rastin e 50 vjetorit të themelimit (Qemal Murati, “Gjuha shqipe sot - prirje të reja “evropianizuese”, ” *Sfida*, No. 4 (2004/2005): 219.

<sup>12</sup> Në dhjetor të vitit 2010, Universiteti i Harvardit në bashkëpunim me Google, kanë nxjerrë këtë të dhënë, të nxjerr nga analiza kompjuterike e mbi pesë milion librave të dixhitalizuar. Richard Alleyne, “English language has doubled in size in the last century”, *The Telegraph*, December 16, 2010, <http://www.telegraph.co.uk/technology/internet/8207621/English-language-has-doubled-in-size-in-the-last-century.html> (parë për herë të fundit më 02/02/2015).

<sup>13</sup> Kenneth F. Kister, “Dictionaries defined,” *Library Journal* 117 No. 11 (June 15, 1992): 43.

<sup>14</sup> *The Oxford English Dictionary and Oxford Dictionaries Online*, s.v. “What is OED”,

<http://oxforddictionaries.com/words/the-oxford-english-dictionary> (parë për herë të fundit më 20/06/2013) .



“gjallë” është kjo gjuhë, mjafton të përmendet një situatë, në grumbullin e të tjerave, sipas të cilës përveç shprehjes “rape” (dhunim seksual) ose “murder” (vrasje), janë krijuar edhe shprehje, të cilat janë në lidhshmëri me këto shprehje, si: “rapee” ose “murderee” për të përcaktuar personat të cilët e provokojnë dhunimin seksual ndaj tij përkatësisht, të vrasjen e tij dhe të tjera.<sup>15</sup> Ndaj edhe shprehjet e përkthyer nga gjuha angleze, vetëm sa do të mund të shkaktojnë (nëse nuk kanë shkaktuar deri më sot) rrezik real për sigurinë juridike dhe më gjerë në Kosovë.

Dhe krejt në fund duhet vë në dukje edhe nevojën e unifikimit të shprehjeve brenda vetë shteteve shqiptare. Kjo duhet të ndodhë jo vetëm në shkencë penale, por edhe në gjuhën e mjeteve të komunikimit masiv. Kështu, për shembull, derisa në Kodin penal të Republikës së Shqipërisë është paraparë “autori” i veprës penale, në të njëjtin kod në Kosovë është paraparë “kryesi” i veprës penale, apo “ekzekutohet” përkatësisht, “vritet”, “proceduriale” përkatësisht, “procedurale”, “inspektoriati” përkatësisht “inspektorati”, forma e “cilësuar” e veprës penale që nënkupton formën e “kualifikuar” të veprës penale, rrethanë “cilësuese” përkatësisht, rrethanë “kualifikuese”, për të vazhduar më tej me “manaxher” përkatësisht “menaxher” apo shprehjet fasilitim,<sup>16</sup> involvim, target, inkludim, e shumë të tjera, të cilat përdoren rëndom në shtypin e shkruar dhe në televizionet tona. “Pastërtinë e gjuhës sonë, natyrën dhe frymën e saj,

---

Gjithashtu, sipas “Vestfold University Kollege”, ky fjalorë përmban: Mbi 300.000 fjalë hyrëse kryesore, mbi 600.000 forma fjalësh, rreth 137.000 shqiptime, thënie, rreth 250.000 etimologji, rreth 577.000 referenca kryqëzore dhe mbi 2,5 milion citate të përdorura. (*Oxford English Dictionary Online*, s.v. “OED Contains”,

<http://www.hive.no/reference-books/oxford-english-dictionary-article11142-2184.html> (parë për herë të fundit më 02/02/2015).

<sup>15</sup> Vjosa Jonuzi – Shala, *Vepra penale e dhunimit dhe veprat tjera penale kundër integritetit seksual sipas Kodit penal të Kosovës – me komentare*, (Prishtinë: Instituti AAB-Rinvest, 2011), 345. [Cituar sipas Vesna Nikolić-Ristanović, *Uticaj žrtve na pojava kriminaliteta*, (Beograd: IRO Svetozar Marković, 1984), 89].

<sup>16</sup> Facility, në gjuhën angleze ka disa kuptime: lehtësi, aftësi, mjet (aparaturë apo instalim industrial, ndërtimor ose sportiv) dhe nyje sanitare. (Morton Benson. *Englesko-srbskohrvatski rečnik*, bot. 2, s.v. “Facility.” Beograd: Prosveta, 1986.

nuk e shëmtojnë vetëm fjalët e huaja të futura e të përdorura me tepri, por e shëmtojnë, e zvetënojnë, e prishin dhe ia zënë frymën (mbase edhe më shumë) edhe fjalët dhe shprehjet e tjera “shqipe” të kalkuluara nga gjuhët e huaja, të cilat sa vijjnë e më shumë po lëshojnë rrënjë e shtat sidomos aty ku edhe duhet të luftohen më së tepërmi e t’u qiten rrënjët në diell – në mjetet e komunikimit tonë masiv (në shtyp e në radiotelevizion), prej nga po përhapen pastaj edhe në mbarë gjuhën tonë.”<sup>17</sup> Gjithsesi, kjo praktikë e tillë duhet luftuar, sepse “pa gjuhë të pasur e të pastër, s’ka as ide e mendime të larta e të përpikta.”<sup>18</sup>

### ***Në vend të përfundimit***

Në emër të të integruarit dhe integrimeve, gjuha shqipe sa vjen dhe pëson. Ndonëse është jo e lehtë që t’i rezistohet kësaj tendence, më së paku që mund të bëjmë është vetëdijesimi, i cili në fakt duhet ndihmuar nga institucionet shtetërore. Nxjerrja e një ligji i cili do të mbronte gjuhën shqipe, së paku do të mund të ndalonte tendencat e tilla, duke i vendosur redaktorët, gjuhëtarët përkatësisht, lektorët në institucione gjithandej, përfshirë edhe sanksionet përkatëse në rastet kur nuk zbatohet ky ligj. Do të ishte më e dobishme që energjitë e shpenzuara me polemika mes gjuhëtarëve dhe ndarja e tyre nëpër taborë për ndryshimin e rregullave të gjuhës shqipe të vendosura dekada më parë, të orientoheshin në ruajtjen e gjuhës tonë, e cila me një intensitet të vrullshëm po “përpihet” nga shprehjet e huaja. Dhe kjo ndodh jo vetëm në komunikimet tona të përditshme në të gjitha nivelet, por edhe në dokumente zyrtare dhe akte të larta juridike, siç janë Kodi penal dhe ai i procedurës penale të Republikës së Kosovës.

---

<sup>17</sup> Qemal Murati, “Vërshimi i kalkeve”, *Gjuha shqipe*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, vol. 3, (1986): 36.

<sup>18</sup> Idriz Ajeti, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes IV*, (Prishtinë: Rilindja, 1989), 47.

## **Bibliografia:**

Ajeti, Idriz. *Studime gjuhësore në fushë të shqipes IV*. Prishtinë: Rilindja, 1989.

Al-Rodhan, Nayef R.F. *Definitions of Globalization: A Comprehensive Overview and a*

*Proposed Definition*. Geneva: Centre for Security Policy, 2006.

Alleyne, Richard. "English language has doubled in size in the last century", *The Telegraph*,

16 Dhjetor, 2010.

<http://www.telegraph.co.uk/technology/internet/8207621/English-language-has-doubled-in-size-in-the-last-century.html> (parë për herë të fundit më 02/02/2015). **{online}**

Benson, Morton. *Englesko-srbskohroatski rečnik*. Bot. 2. Beograd: Prosveta, 1986.

Cooppan, Vilashini. "World Literature and Global Theory: Comparative Literature for the

New Millennium". *Symploke*, Vol. 9, No. 1/2 (2001): 15-43.

*Fjalor i shqipes së sotme*, bot. 2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i gjuhësisë dhe

i letërsisë. Tiranë: Toena, 2002.

Jonuzi, Sh. Vjosa. *Vepra penale e dhunimit dhe veprat tjera penale kundër integritetit seksual sipas Kodit penal të Kosovës – me komentare*. Prishtinë: Instituti AAB-Rinvest, 2011.

Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, 2003. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25.

Kodi penal i Republikës së Kosovës, 2013. Kodi nr. 04/L-082.

Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës, 2013. Kodi nr. 04/L-123.

Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, 2001. Ligji nr. 8733, 24/01/2001.

Kenneth, F. Kister. "Dictionaries defined". *Library Journal*, 117, No. 11 (1992): 43-46.

Murati, Qemal. "Vërshimi i kalkeve". *Gjuha shqipe*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, vol.

3, (1986): 36-37.

“Gjuha shqipe sot - priirje të reja “evropianizuese”. *Sfida*, No. 4 (2004/2005):

217-224.

Vujaklija, Milan. *Leksikon stranih reči i izraza*. Bot. 3. Beograd, Prosveta, 1980.

The *Oxford English Dictionary* and *Oxford Dictionaries Online*,  
<http://oxforddictionaries.com/words/the-oxford-english-dictionary> (parë për herë të fundit më 02/02/2015). **{online}**

**<http://oxforddictionaries.com/definition/english/globalization>**  
(parë për herë të fundit më 02/02/2015). **{online}**

“Vestfold University Kollege”, *Oxford English Dictionary Online*,  
<http://www.hive.no/reference-books/oxford-english-dictionary-article11142-184.html> (parë për herë të fundit më 02/02/2015).  
**{online}**